



Partia e Ashkanlinjëve për Integrim

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2014 - 31 Dhjetor 2014

Përmbajtja:

<u>Raport i auditorëve të Pavarur.....</u>	<u>3</u>
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-11

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partia e Ashkanlinjëve për Integrim

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik Partia e Ashkanlinjëve për Integrim (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PAI” apo “SP”), te përbëra nga pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2014, pasqyra e te hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq. 6-11.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Partia e Ashkanlinjëve për Integrim. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Subjekti politik nuk ka dorëzuar shënime mbi asetet, detyrimet dhe ekuitetin e SP me 31 Dhjetor 2014 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te verifikojmë nëse asetet, detyrimet dhe ekuiteti i deklaruar pasqyrojnë drejt gjendjen SP me 31 Dhjetor 2014.
- Subjekti politik nuk ka dorëzuar ne KQZ kopjet e faturave mbi shpenzimet e raportuara ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë te sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e SP.
- Subjekti Politik nuk ka prezantuar te hyra dhe shpenzime për vitin krahasues 2013 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, edhe pse SP ka zhvilluar aktivitetet përgjatë këtij viti.
- Ne mungese te konfirmimeve nga bankat ne e kishim te pamundur te verifikojmë nëse SP ka vetëm një llogari bankare ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve

politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 11, paragrafi 3.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjë për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një

siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fadil Hyseni
Auditor Ligjor
27 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	3	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	(3.19)	(1.22)
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		(3.19)	(1.22)
Total pasuritë		(3.19)	(1.22)
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(1.22)	(1.22)
Suficiti / (deficiti) i vitit		(1,001.97)	0.00
Total Ekuiteti		(1,003.19)	(1.22)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5		
Detyrimet tjera afatshkurtra	6	1,000.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		1,000.00	0.00
Gjithsej detyrimet		1,000.00	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		(3.19)	(1.22)

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2014	2013
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		21,858.55	
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	7	0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	8		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	2	0.00	
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		21,858.55	0.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	9	11,104.00	
Shpenzimet e transportit	9	203.19	
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	9	598.78	
Shpenzimet e fushatës	9	0.00	
Blerja e mallrave	9	700.00	
Shpenzimet e përgjithshme	9	2,530.00	
Shpenzimet e ndryshme	9	7,724.55	
Gjithsej shpenzimet për vitin		22,860.52	0.00
Suficiti (deficiti) për vitin		(1,001.97)	0.00

1. Informata te përgjithshme

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim është subjekt Politik i Certifikuar nga KQZ , SP ka selinë ne Prishtinë.

Akronimi: PAI

Udhëheqja: Etem Arifi (Kryetar i partisë)

Përfaqësues Financiar: Naim Sefa

Adresa e subjektit politik: Rruga “Maliq Pashë Gjinolli”, pn. Prishtinë

Pasqyrat financiare te Partisë së Ashkanlinjëve për Integrim janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën Raiffeisen Bank Kosovo.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

Subjekti Politik nuk ka prone te paluajtshme.

Shënimi 3. Llogaritë e arkëtueshme

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk ka llogari te arkëtueshme me 31 Dhjetor 2014.

Shënimi 4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Paraja në bankë	(3.19)	(1.22)
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	(3.19)	(1.22)

Shënimi 5. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk ka llogari te pagueshme me 31 Dhjetor 2014.

Shënimi 6. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrimet tjera afatshkurtra	1,000.00	
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	1,000.00	0.00

Shënimi 7: Donacionet dhe kontributet në të holla

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk ka pranuar donacione në të holla për vitin 2014.

Shënimi 8: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk ka pranuar donacione në natyrë në mall dhe shërbime për vitin 2014.

Shënimi 9: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	10,904.00	10,904.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00
Beneficionet tjera	200.00	200.00	0.00
Gjithsej	11,104.00	11,104.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	203.19	203.19	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	203.19	203.19	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	598.78	598.78	0.00
Aktivite kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	598.78	598.78	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	700.00	700.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	700.00	700.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	2,060.00	2,060.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	150.00	150.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	320.00	320.00	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	2,530.00	2,530.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	7,724.55	7,724.55	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	7,724.55	7,724.55	0.00
Gjithsej shpenzimet			
Gjithsej shpenzimet	22,860.52	22,860.52	0.00

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk ka paguar vlera mbi 5,000 EUR një pranuesi të vetëm.